



Pranuar / Dorezuar / Prilazhen / Prilazhe / Received / Delivered	23.06.2023	3	viti god year
Organ / Institucia / Org / Insti	Hi / Prot / Hi / Prot / Prot No	Shtojca / Prilog / Appendix	Sasia / Kolicina / Quantity
SHAMSUK	4896/2023		114



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.770/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga:Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani , si dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.770/2023 të datës 24.05.2023 të parashtruar nga ankuesi me adresë rruga

kundër organit të punësimit/Administrata Tatimore e Kosovës, në çështjen juridike “kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 23.06.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Detyrohet Drejtori i Administratës Tatimore të Kosovës, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi të nxjerr akt administrativ në pajtim me legjislacionin në fuqi lidhur kërkesën me Nr. Port: 1625/06 të datës 12.04.2023 të parashtruar nga ankuesi.

II. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Me Vendimin me Nr. Prot: 69 të datës 08.03.2013 të Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës ankuesi i punësuar në pozitën Inspektor Tatimor është pezulluar nga marrëdhënia e punës me 50% të pagës deri në vendimin përfundimtar të gjykatës. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda përmes Aktgjykimit PKR.nr.932/13 të datës 27.06.2016 ka shpall fajtor ankuesin lidhur me veprën penale për keqpërdorim të pozitës zyrtare ose autoritetit zyrtar.

Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës bazuar në aktgjykimin e lartcekur, me datë 30.06.2016 ka parashtruar kërkesë për inicimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit pranë Komisionit Disiplinor. Komisioni Disiplinor i Administratës Tatimore të Kosovës më datë 11.07.2016 ka nxjerr Vendim Nr. 10/2016 përmes të cilit ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore ndërprerjeje e marrëdhënies së punës.

Kundër Aktgjykimit PKR.nr.932/13 të datës 27.06.2016 pala mbrojtëse e ankuesit ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës ndërsa Gjykata e Apelit e Kosovës-Departamenti për Krime të Rënda me Aktgjykimin PAKR.nr.459.2016 të datës 27.07.2016 lëndën e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda përmes Aktgjykimit PKR.nr.630/16 të datës 22.08.2022 ka liruar nga akuza ankuesin ndërsa ky aktgjykim është vërtetuar me Aktgjykimin PAKR.nr.501/222 të datës 29.12.2022 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Krime të Rënda.

Ankuesi me datë 18.01.2023 ka parashtruar kërkesë në Administratën Tatimore të Kosovës për kthim në vendin e punës, ndërsa sipas Vendimit me Nr.Port:385 të datës 30.03.2023 të Udhëheqësit të Divizionit të Burimeve Njerëzore të Administratës Tatimore të Kosovës është kthyer në vendin e punës duke ju lëshuar Akt Emërimit për pozitën *Inspektor i Mesëm Tatimor*.

Ankuesi më datë 12.04.2023 ka parashtruar kërkesë me Nr. port: 1615/06 në Administratën Tatimore të Kosovës përmes të cilës ka kërkuar kompensimin e të gjitha pagave, shtesave, mbushjeve të telefonit, pagat jubilarë prej kohës së suspendimit deri në ditën e lëshimit të akt emërimit. Njësia e Burimeve Njerëzore përmes emailit të datës 17.05.2023 ka njoftuar ankuesin që është bërë kalkulimi i kompensimit vetëm për periudhën sa keni qenë të pezulluar dhe është dërguar për pagesë ndërsa për periudhën sa keni qenë i larguar nga puna nuk kemi gjetur bazë ligjore për realizimin e kompensimit. Ankuesi lidhur me këtë ka kërkuar vendimin për kompensim, mirëpo është njoftuar se për këtë çështje ka marrë përgjigje dhe mund të ndjek rrugët ligjore.

Ankuesja kundër njoftimit të datës 17.05.2023, më datë 24.05.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 4395/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 30.05.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Administrata Tatimore e Kosovës. Ndërsa Këshilli me datë 01.06.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ,me rastin e shqyrtimit të kësaj ankese ka administruar këto prova:Ankesën me numër protokollit 4395/2023 të datës 22.05.2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt Emërimit e datës 31.03.2023 të ankuesit; Vendimin me Nr.Prot: 385 i datës 30.03.2023; Njoftimin e datës 17.05.2023 për ankuesin nga V.S; Kërkesën e ankuesit përmes emailit e datës 17.05.2023;

Përgjigjen përmes emailit e datës 18.05.2023 nga V.S për ankuesin; Aktgjykimin PKR.nr.630/16 i datës 22.08.2022 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda; Aktgjykimin PAKR.nr.501/22 i datës 29.12.2022 i Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Krime të Rënda; Kërkesën për përgjigje në ankesë datës 30.05.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 01.06.2023; Kërkesën për pagesë retroaktive e datës 11.05.2023; Kërkesën me Nr. Prot: 1625/06 e datës 12.04.2023 dhe 18.01.2023 e ankuesit; Vendimin me Nr. 10/2016 i datës 10.07.2016 i Komisionit Disiplinor; Kërkesën për inicimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit e datës 30.06.2016; Vendimin me Nr. Prot: 69 i datës 08.03.2013 për pezullim parandalues; Lajmërim i pezullimit parandalues i datës 08.03.2013.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës, ka konstatuar se meqenëse nuk është nxjerr akt administrativ në pajtim me legjislacionin në fuqi, atëherë ekziston baza ligjore që të detyrohet Drejtori i Administratës Tatimore të Kosovës të bëjë shqyrtimin e kërkesës me Nr.Prot: 1625/06 të datës 12.04.2023 të parashtruar nga ankuesi dhe të nxjerr akt administrativ, *sepse*:

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se nuk ka marr përgjigje konkrete lidhur me kërkesën e parashtruar dhe po ashtu përgjigja e datës 17.05.2023 përmes emailit nuk i plotëson kushtet e një vendimi me të cilin do të duhej të aprovohej apo refuzohej kërkesa.

Lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshilli, gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike-administrative, konstaton se ankuesi më datë 12.04.2023 ka parashtruar kërkesë me Nr. Port: 1625/06 përmes të cilës ka kërkuar kompensimin e të gjitha pagave, shtesave, mbushjeve të telefonit, pagat jubilarë prej kohës së suspendimit deri në ditën e lëshimit të akt emërimit, mirëpo Njësia e Burimeve Njerëzore e Administratës Tatimore të Kosovës nuk ka nxjerr akt administrativ lidhur me shqyrtimin e kërkesës dhe pretendimeve të paraqitura nga ankuesi, duke mos dhënë arsytetime të qarta dhe konkrete.

Kolegji i Këshillit, lidhur me obligimin e organit publikë që të shqyrtoj në mënyrë të drejtë kërkesën dhe të nxjerr aktin administrativ, ju referuar Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative respektivisht nenit 11 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2, i cili përcakton se: *"3. Organi u siguron personave të interesuar dhe palëve informacion të saktë, të qartë dhe të kuptueshëm rreth: 3.2. kërkesave thelbësore ligjore si dhe procedurave e formaliteteve të parashikuara për nxjerrjen e një akti administrativ apo realizimin e një akti real të kërkuar, përfshirë këtu edhe dokumentet dhe deklaratat që duhen parashtruar"*, nenit 27 paragrafi 1, i cili përcakton se: *"1. Përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj, zyrtari përgjegjës zhvillon procedurën administrative, vendos për çështjen, e nënshkruan vendimin si dhe siguron njoftimin e palës"*, nenit 97 paragrafi 1, i cili përcakton se: *"1. Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon me njoftimin e një akti administrativ apo lidhjen e një kontrate administrative"*, si rezultat i kësaj, Kolegji i Këshillit konstaton se referuar kompetencës sa i përket vendimmarrjes në lidhje me këtë kërkesë e ndërlidhur me bazën ligjore të potencuar si më lartë, konstaton faktin se Drejtori i Administratës Tatimore të Kosovës është i obliguar që të bëjë shqyrtimin e kërkesës me Nr.Prot: 1625/06 të datës 12.04.2023, dhe në pajtim me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative të vendosë përkatësisht të



nxjerr akt administrativ në pajtim me nenin 47 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative dhe të njëjtin ta arsyetoj sipas dispozitave të nenin 48 ndërlidhur me nenin 134 paragrafi 1 të këtij ligji.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr.770/2023, datë 23.06.2023

Avdyl BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Administratën Tatimore të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

